

30 janar 2026,
Prishtinë

Bazuar në Rregulloren për Punën e Komisionit të Ankesave dhe të Arbitrazhit të Federatës së Basketbollit (FBK) të datës 31.01.2025, dhe Rregullores për Regjistrim dhe Kalim (RRRK) të datës 20.08.2025, si dhe sipas Ankesës së KB Vëllaznimi të datës 27.01.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së ("KAA"), me datë 30.01.2026 merr këtë:

V E N D I M

- I. Shpallet e PRANUESHME Ankesa e KB Vëllaznimi e datës 27.01.2026;
- II. REFUZOHET Ankesa e KB Vëllaznimi e datës 27.01.2026 si e PABAZUAR;
- III. VËRTETOHET Vendimi Nr. 25/2025-26 i Komisionit të Garave i datës 26.01.2026.

A R S Y E T I M

Më datë 27.01.2026, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit i FBK-së ("KAA"), përmes postës elektronike, nga Sekretaria e FBK, ka pranuar Ankesën e KB Vëllaznimi të datës 27.01.2026 (tash e tutje "Ankesa"), e cila ka të bëjë me Vendimin me nr. 25/2025-26 të Komisionit të Garave të datës 26.01.2026, (tash e tutje "Vendimi"), lidhur me refuzimin e kërkesës së KB Vëllaznimi për lejimin e regjistrimit të lojtarit Orges Shatri nga KB Istogu me licencë të dyfishtë jashtë afatit kalimtar.

Në këtë kuadër, KAA ka mbajtur takim lidhur me çështjen në fjalë, më 29.01.2026, dhe ka shqyrtuar Ankesën e KB Vëllaznimi, si dhe provat e tjera që janë pjesë e dosjes së lëndës dhe të ofruara nga sekretaria.

Sipas kuptimit të KAA, KB Vëllaznimi sfidon Vendimin e KG të identifikuar më sipër duke pretenduar ndër të tjera se KG është dashur të aprovojë kërkesën për regjistrim të KB Vëllaznimi, bazuar në praktikën e lejimit të regjistrimit të dy lojtarëve të tjerë si lojtarë të lirë "free agent" jashtë afatit kalimtar, përkatësisht Altin Morina dhe Muhamedali Janjeva. Poashtu, KB Vëllaznimi tregon se lojtari nuk ka kontratë aktive me asnjë klub në Superligë, nuk ka zhvilluar ndonjë ndeshje në Superligë gjatë këtij sezoni, është nën moshën 21 vjeçare, dhe regjistrimi i tij nuk cenon integritetin e garave, përkundrazi kontribuon në zhvillimin e lojtarëve të rinj vendor.

KAA vëren nga provat në shkresat e lëndës, dhe është e pakontestueshme, se KB Vëllaznimi ka dorëzuar brenda afatit ankesën e tyre ndaj Vendimit të Komisionit të Garave, dhe rrjedhimisht, konsiderohet si ankesë e pranueshme sepse janë përmbushur të gjitha kushtet, përfshirë edhe pagesën e taksës për ankesë.

KAA gjatë trajtimit të lëndës ka shqyrtuar të gjitha dokumentet përkatëse dhe provat në dispozicion, bazën ligjore dhe nënligjore, dhe rregullativën e brendshme të FBK-së, dhe ka konstatuar si në dispozitiv, për arsyet në vijim.

Vlen të ceket fillimisht, se KAA ka pasur vullnetin që pikërisht për arsye të dhënies së mundësisë së kyçjes së një lojtari të ri vendor në Superligë dhe avancimit të tij, të shihet mundësia ligjore që t'i mundësohet atij regjistrimi si lojtar me licencë të dyfishtë. Në këtë drejtim, KAA ka pasur parasysh dispozitat në vijim nga RRRK:

- Për licencë të dyfishtë - Neni 33: *1. Lojtari deri në moshën 21 vjeçare, i cili ka të drejtë paraqitjeje në Superligë, gjegjësisht në Ligën e Parë, mund të paraqitet për ekip tjetër në nivel më të ulët të garave, me lëshimin e licencës së dyfishtë, në bazë të pëlqimit me shkrim të ekipit për të cilin është i regjistruar lojtari. ...*
- Për lojtarë të lirë - Neni 3, para 4: *Lojtar i lirë (free agent) – lojtar të cilit i ka përfunduar kontrata me ekipin e tij të mëparshëm (nuk ka kontratë aktive/valide) dhe është i lirë të nënshkruajë një kontratë të re me cilindo ekip tjetër. Një lojtar i lirë ka të drejtë të negociojë dhe të pranojë oferta nga ekipet e tjera pa kufizime të vendosura nga ekipi i tij i mëparshëm.*
- Për licencë të dyfishtë - Neni 33, para 3: *Licenca e dyfishtë mund të lëshohet 24 orë para fillimit të pjesës së parë apo të dytë të kampionatit.*

Fatkeqësisht, në rastin konkret, aplikimi për licencim të dyfishtë nuk është bërë brenda afatit 24-orësh para fillimit të pjesës së parë apo të dytë të kampionatit. Në anën tjetër, mundësia e KAA që të lejojë regjistrimin jashtë afatit të lojtarit Orges Shatri si lojtar i lirë “free agent” është penguar nga ndalesa rigjide e paraqitur në Neni 14, pika 3.7.1: *“Regjistrimi i lojtarëve të lirë jashtë afatit kalimtar lejohet vetëm një herë për klub dhe atë deri në përfundim të afatit kalimtar dimëror të sezonit përkatës. Pas kësaj date nuk mund të regjistrohen lojtarë të lirë deri në hapjen e afatit të radhës.”*

Pra, kjo dispozitë është e prerë dhe nuk i len KAA asnjë diskrecion për bërjen e ndonjë përjashtimi. Injorimi i një dispozite të tillë kaq të prerë të RRRK nga KAA do të bënte një precedent të rrezikshëm dhe do ishte shpërfillje arbitrare e një dispozite të qartë juridike, dhe këtë KAA nuk mund ta bëjë përkundër vullnetit që të përkrahë basketbollistët e rinj vendor.

Sa i përket rasteve të tjera në të cilat thirret KB Vëllaznimi, KAA i ka pasur ato parasysh, mirëpo gjen se ato nuk janë të aplikueshme sepse ndalesa nga Neni 14, pika 3.7.1, e cituar më sipër, nuk ka qenë e aplikueshme në ato raste për shkak të kohës kur janë bërë ato transfere. Rrjedhimisht, kjo ndalesë nuk ka ndaluar regjistrimin e atyre lojtarëve si lojtarë të lirë “free agent”.

Duke vlerësuar kështu, KAA nuk ka asnjë bazë ligjore ose të rregullativës së FBK-së, e cila do të arsyetonte përmbushjen e kërkesave ankimore të KB Vëllaznimi në ankesën e parashtruar, prandaj, ato refuzohen si të pabazuara. Prandaj, KAA duke u mbështetur në atë që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Komisioni i Arbitrazhit:



Partin Pruthi
Anëtar



Korab R. Sejdiu
Kryetar



Lulzim Fushtica
Anëtar

Prishtinë, 30 janar 2026

Vendimi i dërgohet:

- KB Vëllaznimi
- Komisionit të Garave të FBK-së
- Anëtarëve të Komisionit të Arbitrazhit
- Arkivit të FBK-së



Këshilla Juridike:

Vendimet e Arbitrazhit janë definitive, dhe kundër tyre nuk është e lejuar ankesa brenda FBK-së. Palët e pakënaqura me vendimin e KAA kanë të drejtë të ankesës tek Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS) dhe në Gjykatën kompetente përkatëse.